

Nr.regj. 18220/2012

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, duke vendosur në procedurën për kundërvajtje kundër të pandehurit Nijazi Shala nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 8 lidhur me nenin 5.1 dhe 6.2 të ndëshkuar me nenin 17 parag.1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, Nr.04/L-050, në bazë të nenit 73-74-195-199 të Ligjit mbi Kundërvajtjet GZK 23/79, me datë **01.08.2012** merr këtë:

AKTVE N D I M

I PANDEHURI: Nijazi Hashim Shala, i lindur më 06.11.1971 në Malloçicë, tani jeton në Prishtinë, me vendbanim në rrugën "Qamil Bala" H-7, Nr.21, lagja Bregu i Diellit, Drejtor i Departamentit për Turizëm dhe Hotelieri në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, me shkollim superior, i martuar, i gjendjes së mirë ekonomike,

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	DPK/DMP
Nr. Prot. Bi Prot Prot No	03-2737/12
Nr. i Jas. E. i Jas. T. i Jas.	02
PRISHTINE	

Ë s h t ë P ë r g j e g j ë s

Sepse, si Zyrtar i Lartë Publik, në pozitë të Drejtor i Departamentit për Turizëm dhe Hotelieri në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, nuk e ka bërë deklarimin e rregullt të gjendjes së pasurisë në Agjencinë Kundër Korrupsionit, brenda afatit ligjor deri më 31.03.2012,

- me çka ka kryer kundërvajtje nga neni 8 lidhur me nenin 5.1 dhe 6.2 të ndëshkuar me nenin 17 parag.1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, andaj të pandehurit për këtë kundërvajtje i shqiptohet,

D Ë N I M I

Me gjobë në shumë prej 1500€ (Njëmijëepesëqind Euro) të cilën shumë i pandehuri është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh, pasi që ky aktvendim të merr formë e prerë, në llogarinë e të hyrave gjyqësore të KGJK-së No.1000 4300 7000 0518. Paguesa bëhet në ndonjërin agjenci për mbledhjen e të hyrave-bankë, përmes urdhërpagesës së plotësuar nga Gjykata. Nëse gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e dhënë, e njëjta do të zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 30 ditësh, duke llogaritur nga 15 Euro për një ditë burgimi. Shpenzime të procedurës nuk ka pasur, kurse në emër të paushallit gjyqësor i pandehuri është i obliguar të paguaj shumë prej 5 Euro në shërbimin e arkës së gjykatës.

Nga një kopje e këtij aktvendimi i dërgohet parashtruesit të kërkesës dhe të pandehurit.

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsionit në Prishtinë, i parashtrroi kësaj gjykate Kërkesën 01-1815/2012 me datë 22.05.2012 për fillimin e procedurës kundërvajtëse ndaj të pandehurit të lartshënuar për kundërvajtjen e precizuar si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Në bazë të kërkesës së parashtruar, gjyqtarja filloi procedurën kundërvajtëse, mori në pyetje të pandehurin i cili në mbrojtjen e vet deklaroi se e pranon kundërvajtjen e cila i vihet në barrë duke shtuar se përkundër faktit se ka qenë me kohë i informuar nga zyrtari i personelit e gjithashtu ka qenë në dijeni edhe nga viti i kaluar, por për shkak të angazhimeve dhe ngarkesave të shumta në punë i kishte kaluar afati ligjor për deklaram të pasurisë, por më vonë kur iu kishte kujtuar obligimi i papërbushur dhe kur e kishte parë seriozitetin e kësaj çështje atëherë e kishte deklaruar pasurinë me vonesë, saktësisht me datë 12.04.2012, për çka prezanton edhe vërtetimin e Agjencisë me të njëjtën datë.


Nga të dhënat në kërkesë, vlerësimi i deklaratës së të pandehurit dhe shqyrtimi i shkresave të tjera të lëndës, administrimi i secilës veç e veç dhe të gjitha së bashku, gjyqtarja në masë të mjaftueshme vërtetoi gjendjen e plotë dhe të drejtë faktike, ekzistimin e veprës kundërvajtëse dhe përgjegjësisë së të pandehurit për këtë kundërvajtje, meqë i njëjti nuk e ka rrespektuar afatin e dhënë ligjor për deklarim të rregullt të pasurisë, thjeshtë çështjen e kishte neglizhuar derisa ka kuptuar seriozitetin dhe pasojën e mosdeklarimit, andaj për kundërvajtjen e kryer i shqiptoi dënimin e paraparë ligjor.

Gjatë shqiptimit të dënimit gjyqtarja pati parasysh rrethanat nga neni 7 i LK në të cilat është kryer kundërvajtja dhe sipas peshës së kundërvajtjes e shkallës së përgjegjësisë së pandehurit, e duke vlerësuar edhe personalitetin e të pandehurit e gjendjen e tij materiale, të njëjtin e dënoi me dënimin me gjobë të precizuar si në dispozitiv të këtij aktvendimi, me bindje se edhe me një gjobë të tillë do të arrihet qëllimi i ndëshkimit dhe se i pandehuri në të ardhmen do të shmanget nga kryerja e ndonjë kundërvajtjeje të natyrës së tillë apo të ngjashme.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

U VENDOS NË GJYKATËN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË
Nr.regj.18220/2012, datë 01.08.2012

Gjyqtarja
Suzana Çerkini



KËSHILLA JURIDIKE kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 8 ditësh Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, nga data e pranimit të njëjtit nëpërmjet kësaj gjykate, pa taksa.